

FJALA E DEPUTETES ERALDA BANO

E MARTË 1 NËNTOR 2022

Faleminderit, zonja Ministre, për të gjithë parashtrimin tuaj të materialit të buxhetit të vitit 2023! Pjesa më e madhe e pyetjeve pak a shumë u ezauruan, megjithatë unë kujtoj që Kryeministri Rama e ka përfunduar rindërtimin në arsim që në vitin 2021. Po ashtu, një pjesë e madhe e fondeve janë donacione të huaja dhe këto nuk mund të jenë pjesë e buxhetit tuaj. Megjithatë, sikurse thatë edhe vetë, ne nuk shkojmë dot në buxhet as me 4%, ndërkohë që e keni premtuar rritjen e buxhetit në arsim që në vitin 2013 në 5%. A mund të na detajoni, për të qenë më të saktë dhe për të kuptuar më shumë, se sa për qind të prodhimit të brendshëm bruto zë arsimit parauniversitar dhe arsimit universitar?

Në fakt, e përmendi dhe kolegu Ndreca, dhe është pak a shumë njëjta pyetje, por dua t'i mëshoj më shumë, duke qenë se janë edhe rektorët këtu: a e kanë mundësinë ekonomike universitetet e rretheve që të bëjnë edhe rritje pagash, kur këto universitete janë në një situatë mbijetese? Sa studentë janë regjistruar në programet prioritare? Kam një merak, duke qenë se jam deputete e qarkut Fier, a i qëndroni premtimit për hapjen e një universiteti mjekësor në Fier në ndihmë të spitalit turk? Pyetja e fundit: a ka ndonjë studim deri sot se si ka shkuar kurrikuala e re? A keni ndonjë studim për kurrikulën e re? Faleminderit!